

# TRANSPAROMETRI KOMUNAL

Transparenca e **38 Komunave**  
të Republikës së Kosovës

2023





Instituti Demokratik i Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e  
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse  
dhe luftës kundër korrupsion përmes  
promovimit të transparencës,  
llogaridhënies dhe integritetit në të  
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

# PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE .....	6
QËLLIMI .....	7
METODOLOGJIA .....	8
LISTA E INDIKATORËVE .....	10
REZULTATET E TRANSPAROMETRIT KOMUNAL 2023 .....	12
VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE NË KOSOVË .....	13
TË GJETURAT KRYESORE NGA MONITORIMI PËR VITIN 2023.....	17
PASQYRA E REZULTATEVE PËR TË GJITHË INDIKATORËT NË 38 KOMUNA PËR VITIN 2023 .....	18
KRAHASIMI I REZULTATEVE TË KOMUNAVE NGA VITI 2022 NË VITIN 2023 .....	26
KOMUNAT SIPAS TRANSPAROMETRIT KOMUNAL PËR VITIN 2023 .....	27
REKOMANDIMET .....	43

COPYRIGHT © 2024. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

**Adresa:** Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 239,  
10000, Prishtinë, Kosovë

**Tel.:** +383 (0)38 248 038

**E-mail:** info@kdi-kosova.org

**Web:** www.kdi-kosova.org

**Bartësit e hulumimit:** Selvije Kurti, Besnik Ramadanaj, Ardian Muçaj

**Layout and design:** Envinion

Realizimi dhe publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme Internacional Center (OPIC). Përmbajtja është përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.





# LISTA E INDIKATORËVE

---

- 1 A janë publikuar njoftimet për seancat e Kuvendit të Komunës dhe rendi i ditës, 7 ditë para mbajtjes së seancave?
- 2 A është i bashkangjitur në thirrje materiali përcjellës për seancë të Kuvendit Komunal?
- 3 A është bërë informimi i qytetarëve për seancat e Kuvendit Komunal në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vende të frekuentuara më shumë, mediave vizive dhe elektronike dhe në rrjete sociale?
- 4 A është e publikuar thirrja për seancën e Komitetit për politikë dhe financa së bashku me rendin e ditës 7 ditë para se të mbahet?
- 5 A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)?
- 6 A janë mbledhjet e komiteteve të përhershme të hapura për publikun?
- 7 A janë të publikuara në ueb-faqen e komunës të dhënat (Emri Mbiemri, Data e lindjes, Email, Telefon, Adresa e banimit, subjekti politik) për të gjithë këshilltarët komunal?
- 8 A ka një historik të shkurtër me të dhënat kryesore në ueb-faqe qe shërben si njoftim me Komunën?
- 9 A e ka të publikuar Kuvendi Komunal planin e Punës?
- 10 A ka KK plan të veprimit për Transparencë 2023 dhe a është publik?
- 11 A janë të publikuara linqe të videove të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre?
- 12 A ka publiku qasje në draft rregulloret e Kuvendit të Komunës?
- 13 A janë publike rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës?
- 14 A janë të publikuar procesverbalet e seancave të Kuvendit Komunal dhe rezultatet e votimit të pikave të rendit të ditës?
- 15 A ka qasje publiku në vendimet e Kuvendit të Komunës?
- 16 A janë seancat e Kuvendi të Komunës të hapura për publikun?
- 17 A transmetohen seancat e Kuvendit të Komunës drejtpërdrejtë, dhe nëse po, përmes çfarë platformave?
- 18 A ka thirrur në raportim Kuvendi i Komunës ose komitetet Kryetarin e Komunës?
- 19 A e ka thirrur KK në raportim drejtorët/eshat në Kuvend dhe komitete?
- 20 A ka mbajtur KK diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?
- 21 A janë të gjitha dokumentet publike në të gjitha gjuhët zyrtare?

### Rezultatet e Transparometrit Komunal 2023<sup>3</sup>

Komuna	Pikë	Përqindje
Drenas	94	97.92
Ferizaj	94	97.92
Lipjan	94	97.92
Prizren	94	97.92
Klinë	93	96.88
Rahovec	92	95.83
Skenderaj	92	95.83
Junik	91	94.79
Kamenicë	90	93.75
Podujevë	89	92.71
Hani i Elezit	89	92.71
Gjakovë	87	90.63
Mitrovicë e Jugut	87	90.63
Vushtrri	87	90.63
Shtime	84	87.50
Suharekë	83	86.46
Kaçanik	83	86.46
Prishtinë	82	85.42
Dragash	81	84.38
Pejë	77	80.21
Istog	76	79.17
Malishevë	74	77.08
Obiliq	68	70.83
Deçan	64	66.67
Graçanicë	61	63.54
Viti	53	55.21
Fushë Kosovë	46	47.92
Gjilan	39	40.63
Mamushë	29	30.21
Novobërdë	28	29.17
Shtërpcë	25	26.04
Klllokot	15	15.63
Mitrovicë e Veriut	13	13.54
Partesh	12	12.50
Leposaviq	2	2.08
Zubin Potok	2	2.08
Zveçan	2	2.08
Ranillug	n/a	n/a

3 Radhitja e Komunave me pikë të njëjta është bërë sipas alfabetit

### Vlerësimi i përgjithshëm i Transparencës së Komunave në Kosovë


Vlerësimi i përgjithshëm sipas Transparometrit Komunal për vitin 2023 tregon se transparenca komunale në nivel komunash përgjithësisht ka shënuar rënie të lehtë krahasuar me raportin e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022. Prandaj, është e nevojshme të vazhdohet puna për rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies, për të ruajtur dhe përmirësuar qëndrueshmërinë e nivelit të transparencës, sidomos në ato komuna që kanë pasur performancë më të dobët sa i përket përmbushjes së standardeve të transparencës.

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal të vitit 2023, një nga sfidat kryesore që KDI ka hasur gjatë mbledhjes së të dhënave është mosfunksionimi i uebfaqeve komunale. Shumë prej këtyre uebfaqeve shpesh bllokohen ose dalin jashtë funksionit, duke penguar kështu publikimin e informacioneve të rëndësishme dhe transparencën në tërësi. Mosfunksionimi i uebfaqeve komunale ndikon negativisht në jetën e qytetarëve, duke u pamundësuar atyre qasjen e barabartë në aktivitete të ndryshme, përfshirë këtu konkurset publike, thirrjet me afate të caktuara ligjore dhe duke krijuar hapësira për keqpërdorime si pasojë e bllokimit ose mosfunksionimit të uebfaqeve dhe seksioneve të ndryshme brenda tyre.

KDI ka kontaktuar Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI), lidhur me këtë çështje, ku përgjigjja ka qenë se janë në proces të zhvillimit të faqeve të reja.

Pasqyrimi i rezultateve të përgjithshme në nivel komunash tregon se konkurrenca midis tyre ka nxitur sukses dhe përmirësim të dukshëm të performancës në disa komuna, ndërsa disa të tjera kanë pësuar rënie. Kjo tregon një mungesë qëndrueshmërie për komunat që kanë qenë më mirë më parë dhe kanë treguar rënie këtë vit. Për ilustrim, shih figurën 1.1.

Fig. 1.1 Performanca e transparencës në komuna nga viti 2022 në vitin 2023




Sigurisht, për kapërcimet e mëdha shihet se ka pasur përpjekje serioze nga disa komuna për të përmirësuar nivelin e transparencës, shih tabelën e mëposhtme.

### Komunat me progresin më të madh në performancën e transparencës gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022

Komuna	Pikë 2022	Pikë 2023	Diferenca në Pikë
Klinë	80	93	13
Skenderaj	79	92	13
Dragash	68	81	13
Junik	73	91	18
Ferizaj	83	94	11
Hani i Elezit	80	89	9
Vushtrri	80	87	7
Drenas	87	94	7
Prizren	88	94	6
Lipjan	89	94	5

Konkretisht, për komunat që kanë shënuar përmirësime të mëdha, është evidentuar një angazhim i shtuar në përmirësimin e performancës. Këto përpjekje përfshijnë publikimin e rregullt të raporteve financiare dhe dokumenteve të tjera publike, mbajtjen e takimeve të hapura me publikun dhe përpjekjet për përfshirje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

**Fig 1.2** Komunat me progresin më të madh në përmbushje të indikatorëve në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022




Përsa i përket komunave që kanë regres, shih tabelën e mëposhtme, përveç kontekstit politik në komunat e veriut, nuk ka të dhëna për pjesët tjera të Kosovës.

### Komunat me rënien më të madhe në performancën e transparencës gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022

Komuna	Pikë 2022	Pikë 2023	Diferenca në Pikë
Leposaviq	48	2	-46
Zveçan	43	2	-41
Gjilan	78	39	-39
Mitrovicë e Veriut	49	13	-36
Mamushë	63	29	-34
Shtërpcë	56	25	-31
Klllokot	45	15	-30
Partesh	35	12	-23
Viti	74	53	-21
Pejë	87	77	-10

Disa nga komunat që kanë përjetuar regres të konsiderueshëm përballen me sfida të ndërlidhura me stabilitetin politik dhe administrativ. Në veçanti, komunat në veri të Kosovës po përballen me kontekste specifike politike që kanë ndikuar negativisht në transparencën dhe llogaridhënien e tyre. Në mungesë të të dhënave të mjaftueshme për komunat tjera të Kosovës, është e vështirë të përcaktohen faktorët e saktë që kanë çuar në këtë regres. Mbetet, shqetësues fakti se te komunat me nivel të ulët të transparencës, ende nuk kuptohet qartë se transparenca është obligim ligjor, dhe jo vullnet vetanak i autoriteteve komunale.

**Fig 1.3** Komunat me rënien më të madhe në përmbushje të indikatorëve në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022






Nga perspektiva e shtyllave kryesore të qeverisjes lokale dhe metodologjisë së zbatuar nga KDI, e cila përfshin matjen e performancës së Kuvendeve Komunale përmes 24 indikatorëve dhe matjen e performancës së Zyrës së Kryetarit përmes 24 indikatorëve të tjerë, të dhënat e përgjithshme për vitin 2023 tregojnë për performancë pak më të mirë të Kuvendeve Komunale krahasuar me degët Ekzekutive. Konkretisht, Kuvendet Komunale kanë arritur të përmbushin indikatorët në vlerë prej 68.45%, ndërsa Zyrat e Kryetarëve në masën prej 64.56%.

Përgjithësisht në nivel vendi, performancë më të mirë të Kuvendeve kanë treguar indikatorët e publikimit të rregullt të thirrjeve për seanca, transmetimit të drejtpërdrejtë të seancave, qasjes së publikut në vendimet e Kuvendit dhe organizimit të dëgjimeve buxhetore. Megjithatë, vazhdon të ketë ngecje në publikimin e materialeve të Kuvendit. Po ashtu, ngecje në transparencë në nivel komunal vërehet edhe tek indikatorët si: thirrja për raportim e Kryetarit dhe drejtorëve në Kuvend dhe komitete, si dhe mbajtja e diskutimeve brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tremujore.

Fig 1.3 Transparenca - Kuvendi Komunal dhe Zyra e Kryetarit/es në nivel vendi.

### Krahasimi i Performancës së Transparencës mes Kuvendeve Komunale dhe Zyrës së Kryetarit/es (degët Ekzekutive) në nivel të Kosovës



Ngjashëm si në Kuvendet Komunale, mungesa e transparencës është më e theksuar në punën e ekzekutivit. Sipas indikatorëve, rreth 40% e komunave nuk e kanë publikuar planin e punës së kryetarit për vitin 2023, ndërkohë që rreth 86% e uebfaqeve të komunave nuk ofrojnë informacion në gjuhët zyrtare. Mostransparenca është më e theksuar edhe në publikimin e vendimeve të kryetarëve, publikimin e borxhit publik komunal, listën e pronave të dhëna me qira dhe të hyrat vetanake të komunës. Po ashtu, gjetjet adresojnë edhe organizimin e takimeve publike dhe publikimin e aktiviteteve në uebfaqe, organizimin e dëgjimeve buxhetore dhe publikimin e raportit ose procesverbalit nga këto dëgjime, si dhe publikimin e buxhetit të komunës për vitin 2023.

## TË GJETURAT KRYESORE NGA MONITORIMI PËR VITIN 2023

- Rreth **52% e komunave** nuk i publikojnë **materialet e seancave** të Kuvendit Komunal. Kjo mungesë transparence pengon qytetarët dhe aktorët e tjerë të interesuar të informohen mbi diskutimet dhe vendimet e marra nga përfaqësuesit e tyre të zgjedhur.
- Rreth **86% e komunave** nuk ofrojnë **qasjen në dokumente në gjuhët zyrtare**. Kjo përjashton një pjesë të popullsisë së Kosovës nga qasja e barabartë në informacione, duke krijuar barriera gjuhësore që pengojnë transparencën.
- Rreth **32% e Kuvendeve Komunale** nuk kanë mbajtur **diskutime brenda afateve ligjore** mbi shpenzimet tre-mujore. Kjo mungesë diskutimi ndikon në mbikqyrjen dhe llogaridhënien financiare të komunave ndaj qytetarëve dhe të zgjedhurve të tyre në nivel lokal.
- Rreth **30% e kryetarëve** nuk raportojnë para **Kuvendeve Komunale**. Kjo mungesë transparence dhe llogaridhënie pengon mbikëqyrjen efektive të ekzekutivit lokal nga ana e përfaqësuesve të zgjedhur, si një nga parimet kryesore të demokracisë të paraparë me ligj.
- Rreth **40% e komunave** nuk publikojnë **planin e punës** të kryetarëve. Kjo mungesë informimi i lë qytetarët pa mundësinë për të parë dhe vlerësuar prioritetet dhe qëllimet e qeverisjes lokale.
- Rreth **50% e komunave** nuk kanë publikuar **borxhin komunal**. Kjo tregon për një mungesë transparence në menaxhimin e financave publike, duke e bërë të vështirë për qytetarët të kuptojnë gjendjen financiare të komunës së tyre.
- Rreth **32% e komunave** nuk kanë informata për **koordinatorin për qasje në dokumente zyrtare** dhe nuk kanë raporte të përgjigjeve në kërkesa zyrtare të publikuara. Kjo e bën të vështirë për qytetarët të dinë ku të drejtohen për të kërkuar informacione.
- Rreth **42% e komunave** nuk kanë publikuar **listën e pronave** të dhëna me qira. Kjo mungesë transparence mund të krijojë dyshime mbi procesin e dhënies me qira të pronave publike dhe të ndikojë në besimin e qytetarëve ndaj qeverisjes lokale.
- Rreth **50% e komunave** nuk kanë bërë **konsolidimin e bashkësive lokale** dhe nuk kanë informata publike rreth tyre. Kjo tregon për një mungesë angazhimi në ndërtimin e strukturave të qeverisjes lokale që janë të qarta dhe të parapapra me ligj si mekanizma për rritjen e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse.
- Rreth **35% e komunave** nuk kanë publikuar një **listë me shërbimet** që ofrojnë për qytetarët, dhe ato që kanë publikuar këtë listë, shumica janë të vështira për t'u gjetur në uebfaqe. Kjo mungesë informimi pengon qytetarët të marrin informata dhe shërbime të nevojshme në kohë dhe me lehtësi.
- Një problem gjithëpërfshirës në nivel komunash është **formatet e paqarta, organizimi i dobët, mos emërtimi adekuat i dokumenteve dhe moshapja e të dhënave (open data)** në uebfaqe që bëjnë të vështirë qasjen në dokumente. Kjo problematikë pengon qytetarët, shoqërinë civile dhe mediat për të gjetur dhe përdorur informacionet që u duhen.

Pasqyra e rezultateve për të gjithë indikatorët në 38 Komuna për vitin 2023

Kuvendi Komunal

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15

- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25
- 26
- 27
- 28
- 29
- 30
- 31
- 32
- 33
- 34
- 35
- 36
- 37
- 38

Indikator	Dragash	Vushtrri	Gjakovë	Ferizaj	Graçanicë	Rahovec	Mitrovicë	Prishtinë	Zubin Potok	Shtërpcë	Suharekë	Zveçan	Leposaviq	Mitrovicë Veriore	Gjilan	Kamenicë	Drenas	Istog	Obiliq	Lipjan	Shtime	Podujevë	Novobërdë	Ranillug	Partesh	Kllokot	Viti	Fushë Kosovë	Skenderaj	Malishevë	Prizren	Mamushë	Klinë	Pejë	Deçan	Junik	Kaçanik	Hani i Elezit			
1 A është e publikuar thirrja për seancën e kuvendit komunal së bashku me rendin e ditës 7 ditë para se të mbahet, gjatë vitit 2023?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	1	2	2	2	2	2	2	2	2	1	2	2	2	2	2	2	2		
2 A është i bashkangjitur në thirrje materiali përcjellës për seancë të Kuvendit Komunal?	0	2	0	2	0	2	2	0	0	0	1	0	0	0	1	2	2	0	1	2	0	2	0	0	0	2	0	2	1	2	0	2	2	0	2	2	0	2	2	2	2
3 A është bërë informimi i qytetarëve për seancat e Kuvendit Komunal në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vende të frekuentuara më shumë, mediave vizive dhe elektronike dhe në rrjete sociale?	2	2	2	2	1	2	2	2	0	0	1	0	0	0	1	2	2	2	1	2	2	2	1	0	0	2	0	2	2	2	2	0	2	2	2	1	2	2	1	2	2
4 A është e publikuar thirrja për seancën e Komitetit për politikë dhe financa së bashku me rendin e ditës 7 ditë para se të mbahet?	2	1	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	1	2	1	0	0	0	0	2	2	2	2	1	2	1	1	2	1	2			
5 A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	1	2	2	2	2	2		
6 A janë mbledhjet e komiteteve të përherëshme të hapura për publikun?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	
7 A janë të publikuara në uebfaqen e komunës të dhënat (Emri Mbiemri, Data e lindjes, Email, Telefon, Adresa e banimit, subjekti politik) për të gjithë këshilltarët komunal?	0	2	2	2	1	2	2	2	0	0	1	0	0	0	1	2	1	2	2	2	2	2	1	0	0	2	0	2	1	2	0	2	1	2	0	2	1	0	2	2	2
8 A ka një historik të shkurtër me të dhënat kryesore në uebfaqe që shërben si njoftim me Komunën?	2	2	2	2	1	2	2	2	0	0	2	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	1	2	0	2	0	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	2	
9 A e ka të publikuar Kuvendi Komunal planin e Punës për vitin 2023?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2		

|||||

|||||

10	A ka KK plan të veprimit për Transparencë 2023 dhe a është publik?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	0	2	0	0	2	2	2		
11	A janë të publikuara linqe të videoeve të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2	1	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2		
12	A ka publiku qasje në draft rregullores të Kuvendit Komunal?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	1	0	0	1	0	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	
13	A janë publike rregulloret e miratuara të KK?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	1	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	
14	A janë të publikuara procesverbale të seancave të Kuvendit Komunal dhe rezultatet e votimit të pikave të rendit të ditës?	2	2	2	2	2	1	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	1	1	2	0	0	2	2	2	2	0	2	1	2	2	2	2	
15	A ka qasje publiku në vendimet të KK?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	1	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	
16	A janë seancat e hapura për publik?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	
17	A transmetohet seancat e Kuvendit drejtëpërdrejtë, nëse po në çfarë platforme?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	1	0	2	2	2	0	2	0	0	2	2	2	
18	A e ka thirrë KK në raportim Kryetarit në Kuvend dhe komitete/	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2	2	1	2	2	0	2	1	0	0	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	
19	A e ka thirrë KK në raportim drejtorët/eshat në Kuvend dhe komitete?	2	2	0	2	2	2	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0	2	2	2	2	1	0	0	1	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	
20	A ka mbajtur KK diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?	2	2	0	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	2	0	0	0	2	2	2	1	2	0	2	2	2	2	2	2	
21	A janë të gjitha dokumentet publike në të gjitha gjuhët zyrtare?	1	1	1	2	2	2	1	1	0	1	1	0	0	0	1	1	2	1	1	1	1	1	1	0	1	0	1	1	0	1	1	1	0	0	1	1	0	
22	A ka mbajtur Kuvendi i Komunës diskutime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)?	2	0	2	2	2	2	1	1	0	0	2	0	0	0	0	2	2	1	2	2	2	2	1	0	2	1	2	2	0	2	0	2	1	1	1	0	0	
23	A ka mbajtur KK diskutime publike për KAB gjatë vitit 2023?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	1	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	1	2
24	A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?	2	2	2	2	0	1	2	1	0	0	2	0	0	0	0	2	2	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	2	1	0	0	2	0	2	2	2	

|||||

|||||



**ZYRA E KRYETARIT/ES**

25	A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res (email, nr. kontaktues, biografi etj)	2	2	2	2	1	2	2	2	0	0	2	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	1	2	2	2	2	2	2	2	1	2	2	2	2		
26	A janë të publikuara detajet biografike të drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)	1	2	2	2	1	2	2	2	0	0	2	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	1	2	2	2	1	2	0	2	2	2	2		
27	A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë?	0	2	2	2	0	0	2	2	0	0	2	0	0	0	0	1	2	2	0	2	1	2	0	0	0	0	2	0	2	0	2	2	0	2	0	2	0	2	
28	A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara për qytetarët?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	
29	A ka koordinator/e për qasje në D.Z si dhe a është publik raporti me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	2	1	0	0	2	0	2	1	2	0	2	2	2	2	2	2	2	
30	A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)?	2	2	2	2	0	2	2	1	0	0	2	0	0	0	0	2	2	0	0	2	0	2	1	0	0	1	0	2	2	2	0	2	2	2	2	2	0	2	
31	Si qëndron niveli i përgjegjeve për qasje në D.Z?	2	2	2	2	2	2	0	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	0	2	2	2	2	0	0	0	2	0	2	0	2	0	2	0	2	0	2	2	2	2
32	A është publik plani i punës të Kryetarit/res për vitin 2023?	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	0	0	0	2	2	2	0	2	2	2	2	0	0	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2
33	A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës?	1	1	2	2	2	2	1	2	2	1	2	2	2	2	2	1	2	1	2	1	1	1	0	1	0	2	1	0	2	2	2	2	2	2	1	1	0		
34	A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	2
35	A është borxhi publik komunal, i publikuar?	2	0	0	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	2	0	0	0	0	2	0	2	0	2	0	2	0	2	2	0	2	
36	A është publike lista e pronave të dhëna me qira nga Komuna?	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	0	2	0	2	1	1	
37	A ka të dhëna mbi të hyrat veta-nake të Komunës?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	2	0	2	2	2	0	2	2	2	1	0	0	1	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	2	



|||||

|||||

38	A është bërë hapja e të dhënave statistikore Open Data?	0	2	2	2	0	2	0	1	0	0	1	0	0	0	0	1	2	1	0	1	2	1	0	0	0	0	0	2	0	2	0	2	1	1	2	2	2	
39	A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	
40	A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	1	0	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2
41	A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët?	0	2	2	2	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	2	2	2	1	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2	
42	A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun?	0	2	2	0	2	2	2	2	0	0	1	0	0	2	1	2	2	0	2	2	2	1	1	0	0	0	0	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	
43	A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?	2	0	2	2	0	2	1	0	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	0	2	2	2	0	2	1	0	2	2	2	
44	A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	0	2	2	2	1	2	2	
45	A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	1	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	
46	A janë organizuar dëgjime buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi i komunës për buxhetin e vitit 2024, para afatit të dorëzimit të buxhetit?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	2	0	0	0	2	0	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	
47	A ka raport ose procesverbal nga dëgjimet buxhetore të organizuara në vitin 2023 dhe a është publik.	2	2	2	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	2	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2	
48	A është buxheti i komunës për vitin 2023 i publikuar në uebfaqen e komunës.	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	0	2	2	0	0	2	2	2	0	0	1	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2	
<b>TOTALI</b>		<b>81</b>	<b>87</b>	<b>87</b>	<b>94</b>	<b>61</b>	<b>92</b>	<b>87</b>	<b>82</b>	<b>2</b>	<b>25</b>	<b>83</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>13</b>	<b>39</b>	<b>90</b>	<b>94</b>	<b>76</b>	<b>68</b>	<b>94</b>	<b>84</b>	<b>89</b>	<b>28</b>	<b>n/a</b>	<b>12</b>	<b>15</b>	<b>53</b>	<b>46</b>	<b>92</b>	<b>74</b>	<b>94</b>	<b>29</b>	<b>93</b>	<b>77</b>	<b>64</b>	<b>91</b>	<b>83</b>	<b>89</b>

|||||

|||||

## Krahasimi i rezultateve të komunave nga viti 2022 në vitin 2023

Komuna	Pikë 2022	Pikë 2023
Rahovec	90	92
Lipjan	89	94
Prizren	88	94
Drenas	87	94
Gjakovë	87	87
Kamenicë	87	90
Pejë	87	77
Prishtinë	87	82
Mitrovicë e Jugut	86	87
Podujevë	84	89
Ferizaj	83	94
Suharekë	82	83
Kaçanik	80	83
Hani i Elezit	80	89
Klina	80	93
Shtime	80	84
Vushtrri	80	87
Skenderaj	79	92
Istog	79	76
Malishevë	78	74
Gjilan	78	39
Graçanicë	75	61
Viti	74	53
Junik	73	91
Obiliq	71	68
Deçan	70	64
Dragash	68	81
Mamushë	63	29
Shtërpcë	56	25
Fushë Kosovë	50	46
Mitrovicë e Veriut	49	13
Leposaviq	48	2
Klllokot	45	15
Zveçan	43	2
Novobërdë	37	28
Partesh	35	12
Zubin Potok	33	2
Ranillug	44	n/a

KOMUNAT<sup>4</sup> SIPAS TRANSPAROMETRIT KOMUNAL PËR VITIN 2023

Në këtë raport janë paraqitur gjetjet dhe rezultatet e komunave veç e veç, ku janë ofruar të dhëna përkatëse për secilën komunë lidhur me disa nga treguesit pozitivë dhe ngecjet gjatë vitit 2023. Raporti thekson pikat e forta të komunave dhe identifikon fushat që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

## Ferizaj

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Ferizajt, është vlerësuar me 94 pikë, nga 83 sa kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka arritur të shënojë progres të theksuar në indikatorët e matur.

## Rezultatet pozitive

Komuna e Ferizajt ka shënuar progres të qind për qind në gati të gjithë indikatorët që kishin ngecje në vitin paraprak. Është përbushur indicatori sa i përket publikimeve në uebfaqe të të dhënave për këshilltarët komunal dhe procesverbaleve të seancave të Kuvendit Komunal, ndërsa janë mbajtur të gjitha diskutimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB). Është përbushur rekomandimi rreth publikimit në uebfaqe të borxhit publik komunal. Përveç progresit në hapjen e të dhënave statistikore Open Data, kjo komunë ka arritur që në 2023 ta funksionalizojë edhe një linjë direkte pa pagesë për qytetarët.

## Mangësitë

Edhe pse ka shënuar progres në nivelin e përgjithshëm të transparencës, Komuna e Ferizajt e ka vështirë të qasshme listën e shërbimeve për qytetarët, gjë që do t'u lehtësonte procedurat për shërbime me dokumente.

## Drenas

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Drenasit është vlerësuar me 94 pikë nga 87 pikë sa kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka arritur të shënojë progres të theksuar në indikatorët e matur.

## Rezultatet pozitive

Në përgjithësi, Komuna e Drenasit ka shënuar progres të ndjeshëm në vitin 2023 krahasuar me vitin paraprak. Progres maksimal ka shënuar në trajtimin dhe regjistrimin e kërkesave të qytetarëve përmes një mekanizmi përcjellës që ishte një mangësi në vitin 2022. Përmirësim vërehet edhe tek qasja në të gjitha gjuhët zyrtare në uebfaqën e komunës, ndonëse ende ka nevojë të plotësohet. Ngjashëm ka shënuar progres edhe në publikimin e dokumenteve në të gjitha gjuhët zyrtare. Borxhi publik komunal tashmë mund të gjendet në uebfaqën e komunës i plotë dhe pa mangësi. Gjithashtu ka përmirësim në hapjen e të dhënave (Open Data) për qytetarët, një mundësi kjo që nuk ishte e mundur një vit më herët.

<sup>4</sup> Radhitja e komunave është bërë rastësisht dhe nuk ka ndonjë qëllim specifik.







### Mangësitë

Komuna e Istogut gjatë vitit 2023 ka pasur ngecje në dy indikatorë: nuk e ka bashkëngjitur materialin e kuvendit dhe nuk e ka publikuar buxhetin komunal për vitin 2023. Përveç kësaj, nuk ka bërë konsolidimin e bashkësive lokale.

## Pejë

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Pejës është vlerësuar me 77 pikë, nga 87 sa kishte një vit më herët. Te kjo komunë vërehet një rënie në disa prej indikatorëve të transparencës, por në përgjithësi ka mirëmbajtur nivelin e transparencës.

### Rezultatet pozitive

Si një nga arritjet kryesore për këtë komunë është mbajtja e dëgjimeve publike, ku vlen të përmendet dëgjimi publik me qytetarë për buxhetin e vitit 2023. Kjo praktikë është përcjellë edhe me materiale përcjellëse për qytetarët dhe është bërë publikimi i procesverbaleve nga këto dëgjime. Edhe indikatorët që kanë të bëjnë me qasjen e komunës ndaj kërkesave të qytetarëve kanë marrë pikë maksimale. Është funksionale linja direkte pa pagesë për qytetarët, po ashtu kur qytetarët ankohen, edhe në këtë komunë ekzistojnë mekanizma për regjistrim të ankesave. Ka rritje të transparencës edhe në punën e Kuvendit Komunal.

### Mangësitë

Probleme të theksuara kjo komunë ka me respektimin e parimit të përdorimit të të gjitha gjuhëve zyrtare kur i publikon dokumentet zyrtare.

## Malishevë

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Malishevës është vlerësuar me 74 pikë, nga 76 sa kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka mirëmbajtur nivelin e transparencës me një rënie të vogël.

### Rezultatet pozitive

Nga të gjithë indikatorët e matur, edhe në këtë komunë ka rritje të transparencës në mbajtjen e dëgjimeve publike për qytetarët. Sa i përket dëgjimeve publike dhe qasjes në informata për këto organizime, si procesverbalet dhe materialet që u shpërndahen qytetarëve, indikatorët janë vlerësuar maksimalisht.

### Mangësitë

Komuna e Malishevës nuk ka mbajtur konsultime publike për KAB gjatë vitit 2023. Një mangësi tjetër e theksuar është mospublikimi i borxhit komunal për vitin 2023. Gjithashtu, nuk ka informata të publikuara lidhur me nivelin e përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare.

## Obiliq

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Obiliqit është vlerësuar me 68 pikë, nga 71 pikë sa kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka shënuar rënie të lehtë në përmbushje të indikatorëve të transparencës.

### Rezultatet pozitive

Komuna e Obiliqit ka arritur transparencë deri diku të kënaqshme në organizimin e punëve të Kuvendit Komunal. Në përgjithësi është realizuar plani i punës së Kuvendit Komunal duke i mbajtur 10 mbledhjet e parapara. Dy të arritura me rëndësi të kësaj komune vlen të përmenden mbajtja e diskutimeve publike për KAB dhe buxhetin e vitit 2024.

### Mangësitë

Komuna e Obiliqit nuk ka informata që ka bërë konsolidimin e bashkësive lokale as në vitin 2023. Poashtu ka mangësi të theksuara në punën e Kuvendit Komunal dhe dëgjimeve buxhetore.

## Deçan

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Deçanit ëshë vlerësuar me gjithsej 64 pikë, nga 70 sa kishte gjatë vitit 2022. Kjo komunë ka shënuar një rënie të lehë në përmbushje të indikatorëve e transparencës.

### Rezultatet pozitive

Komuna e Deçanit ka arritur të mirëmbajë transparencën në punën e Kuvendit Komunal, si dhe në organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarët. Gjithashtu, për vitin 2023, komuna ka qenë transparente në publikimin e vendimeve të Kryetarit. Këto indikatorë tregojnë një angazhim të vazhdueshëm për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe për të ofruar informata të rëndësishme në lidhje me vendimmarrjen komunale.

### Mangësitë

Sipas gjetjeve, Komuna e Deçanit nuk ka përmbushur disa prej indikatorëve shumë të rëndësishëm siç është publikimi i listës së pronave të dhëna me qira për vitin 2023. Gjithashtu, nuk ka të publikuara procesverbalet nga dëgjimet buxhetore. Ka mangësi të transparencës sa i përket konsolidimit të Bashkësive lokale. Këto aspekte duhet të adresohen për të përmirësuar më tej nivelin e transparencës dhe për të siguruar qasje të plotë dhe të drejtë në informatat publike për të gjithë qytetarët.

## Lipjan

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Lipjanit është vlerësuar me 94 pikë nga 89 pikë sa kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka arritur të shënojë progres në indikatorët e matur.







## Hani i Elezit

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Hanit të Elezit është vlerësuar me 89 pikë për vitin 2023, nga 89 pikë sa kishte në raportin e fundit të vitit 2022. Kjo komunë ka shënuar progres në përmbushjen e indikatorëve për transparencë.

### Rezultatet Pozitive

Hani i Elezit ka shënuar progres në nivelin e përgjithshëm të transparencës, duke performuar mirë sa i përket publikimit të thirrjeve për seanca dhe materialeve përcjellëse, si dhe në indikatorët që prezantojnë punën e Kryetarit. Gjithashtu, komuna ka treguar përkushtim në organizimin e dëgjimeve buxhetore.

### Mangësitë

Megjithëse ka shënuar progres, nuk janë gjetur informata që gjatë vitit 2023 janë mbajtur takime për Kornizën Afatmesme Buxhetore. Po ashtu, uebfaqja vazhdon të mbetet e mangët sa i përket dygjuhësisë.

## Mitrovicë Veriore

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Mitrovicës Veriore është vlerësuar me vetëm 13 pikë nga 49 që kishte në Transparometrën e vitit 2022. Kjo komunë ka shënuar regres të madh në përmbushjen e indikatorëve për transparencë.

Rënia e ndjeshme e transparencës nuk ka krijuar hapësirë për të evidentuar ndonjë gjetje të theksuar, megjithatë, vlen të përmendet se ekzistojnë të dhëna mbi biografinë e kryetarit dhe drejtorëve, si dhe historikun e shkurtër të komunës. KDI ka kontaktuar komunën në fjalë, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

## Zveçan

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Zveçanit është vlerësuar me vetëm 2 pikë, nga 43 sa i kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka shënuar një rënie drastike në përmbushje të indikatorëve të transparencës.

Kjo rënie drastike është reflektim i kontekstit politik të krijuar në atë komunë, duke shkaktuar një mungesë të theksuar të informacionit mbi aktivitetet dhe vendimet e komunës. Kjo gjendje pengon qytetarët të kenë qasje në të dhënat e rëndësishme, duke ndikuar negativisht në transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve lokale. KDI ka kontaktuar komunën në fjalë, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

## Leposaviq

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Leposaviqit është vlerësuar me vetëm 2 pikë, nga 48 pikë sa kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka pësuar një rënie drastike në përmbushje të indikatorëve të transparencës.

Konteksti politik i krijuar në katër komunat e veriut, përfshirë Leposaviqin, ka ndikuar ndjeshëm në aftësinë e autoriteteve lokale për të siguruar transparencë dhe qasje të qytetarëve në informata kyçe. Kjo situatë i privon qytetarët nga informacionet e nevojshme për të mbikëqyrur dhe vlerësuar punën e komunës. KDI ka kontaktuar komunën në fjalë, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

## Zubin Potok

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Zubin Potokut është vlerësuar me vetëm 2 pikë, nga 33 sa kishte në vitin 2022. Kjo komunë ka shënuar regres të theksuar në përmbushje të indikatorëve të transparencës.

Konteksti politik ka ndikuar në krijimin e kësaj situatë, duke e bërë të vështirë për qytetarët të kenë qasje në të dhënat e rëndësishme dhe të mbajnë përgjegjëse autoritetet lokale për vendimet e tyre. KDI ka kontaktuar komunën në fjalë, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

## Viti

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Vitisë është vlerësuar me gjithsej 53 pikë, nga 74 pikë në total që kishte në raportin e fundit të vitit 2022. Kjo tregon një rënie të përmbushjes së indikatorëve të transparencës.

### Rezultatet Pozitive

Komuna e Vitisë ka qenë aktive dhe transparente duke publikuar thirrjet për seancat e kuvendit komunal, së bashku me rendin e ditës, 7 ditë para mbajtjes gjatë vitit 2023. Gjithashtu, ka bashkangjitur materialet e kuvendit për publikun. Sipas gjetjeve, vlen të theksohet se qytetarët kanë qasje edhe në rregulloret komunale.

### Mangësitë

Në Komunën e Vitisë nuk është gjetur plani i transparencës së komunës për vitin 2023. Procesverbalet e seancave: Nuk ka informata që janë publikuar procesverbalet e seancave, çka tregon një mangësi në dokumentimin dhe shpërndarjen e informacionit për seancat e mbajtura. Këshillat e fshatrave: Nuk është gjetur ndonjë informatë për konsolidimin e këshillave të fshatrave, çka tregon mungesë përfshirje dhe koordinimi me komunitetet rurale. Ky raport tregon nevojën për përmirësime të mëtejshme në transparencën dhe përfshirjen e komunitetit nga Komuna e Vitisë.

## Shtërpcë

Sipas gjetjeve të Transparometrit Komunal për vitin 2023, Komuna e Shtërpcës është vlerësuar me 25 pikë për vitin 2023, nga 56 pikë që kishte gjatë raportit të fundit për vitin 2022. Kjo tregon një rënie të theksuar në përmbushje të indikatorëve të transparencës.



Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT):



Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT) është themeluar në vitin 2020 dhe ka për synim të avokoj dhe lloboj tek institucionet lokale dhe qendrore në rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien institucionale. Anëtarët e AQT janë: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, OJQ IQS, OJQ SHIP, OJQ FOJK si dhe KDI. AQT gjatë vitit 2021 është plotësuar edhe Mundësia NGO, 2. Polis, 3. AvoNet, 4. Qeliza, 5. Gjethi, 6. Center for Peace and Tolerance, 7. Center for Policies and Advocacy (QPA), 8. OJQ SHL Kosova, 9. Iniciativa Qytetare Skenderaj (IQS), 10. Ekovizioni, 11. NGO Fortesa, 12. Syri i Vizionit.

Ky raport është mundësuar me përkrahjen financiare të:

